

VENDIM
Nr. 692, datë 22.10.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR.35, DATË 29.1.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME PËR VITIN 2014 NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014 në njësitë e qeverisjes qendrore është 907 veta, sipas lidhjeve nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5 e nr.6, që i bashkëlidhen vendimit në fuqi dhe janë pjesë përbërëse të tij, dhe sipas lidhjes

nr.7, që shtohet e që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila detajon ndarjen e shtesës prej 20 punonjësish, të miratuar me këtë vendim."

b) Periudha kohore e përcaktuar për punonjësit e ALUIZNI-t në lidhjen nr.5, të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhet "1.7.2014 - 30.12.2014".

c) Emërtesa "punonjës protokoli/arkivist" për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, e përcaktuar në lidhjen nr.1, të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhet "Specialist protokoli/arkivi".

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin përkatës të institucioneve për vitin 2014.

3. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore, sipas lidhjes nr.7, të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr.7

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
14	Ministria e Drejtësisë	10			
	<i>Qendra e Publikimeve Zyrtare</i>	5	Specialist	8 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Qendra e Publikimeve Zyrtare</i>	3	Operator	8 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Qendra e Publikimeve Zyrtare</i>	1	Korrektor	8 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Qendra e Publikimeve Zyrtare</i>	1	Korrier	8 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
13	Ministria e Shëndetësisë	1			
	<i>Qendra Kombëtare Biomjekësore</i>	1	Operator	8 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
87	Inspektorati Qendror	1			
	<i>Specialist protokoli/ arkiv/ sekretar</i>	1	Specialist	8 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	8			
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë-2</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Shkodër</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Lezhë</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Kukës</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Dibër</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Gjirokastrë</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	<i>Drejtoria e ALUIZNI-t Berat</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	15.10.2014-31.12.2014
	Total, punonjës me kontratë	20			

